



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:104423

Datë: 17.10.2024

Numri i dokumentit: 06316772

PPP.nr.9/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike të përmbarimit, sipas propozimit për përmbarim të kreditores Gj me seli në Gjakovë, kundër debitorit të përmbarimit M.B.Th nga fshati Retijë, Komuna e Rahovecit, për përmbarimin e dokumentit të besueshëm – faturës, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 534.79 euro, i lejuar me urdhrin për përmbarim, P.nr.85/2024 të datës 22.01.2024, të përmbaruesit privat, G.Gj nga Gjakova, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të përmbarimit, jashtë seancës gjyqësore, më datë 17.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë si i pas afatshëm prapësimi i debitorit të përmbarimit, M.B.Th nga fshati Retijë, Komuna e Rahovecit, të ushtruar kundër urdhrin për përmbarimor P.nr.85/2024 të datës 22.01.2024, të përmbaruesit privat, G.Gjnga Gjakova.

A r s y e t i m

Organi i përmbarimit, përmbaruesi privat G.Gjnga Gjakova, me urdhrin për përmbarim, P.nr.85/2024 të datës 22.01.2024, ka lejuar propozimin për përmbarim të kreditores Gjme seli në Gjakovë, të paraqitur kundër debitorit të përmbarimit M.B.Th nga fshati Retijë, Komuna e Rahovecit, për përmbarimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 534.79 euro, në emër të shpenzimeve publike – furnizim me ujë të pijshëm.

Në vazhdim, lidhur me këtë çështje juridike të përmbarimit, përmbaruesi privat G.Gjnga Gjakova, debitorit të përmbarimit më datën 01.02.2024 për herë të parë ka tentuar t'ia dorëzoj urdhrin për përmbarimor, ku në fletëkthesë është konstatuar se dera ka qenë e mbyllur. Ndërsa në tentimin e dytë me datën 05.02.2024 sipas konstatimit në fletëkthesë urdhrin për përmbarimor P.nr.85/2024 të datës 22.01.2024, e ka pranuar bashkëshortja e debitorit.

Më datë 07.03.2024 debitori i përbarimit, nëpërmjet dorëzimit postar ka paraqitur prapësim. Lidhur me këtë prapësim, më datë 12.03.2024, kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim

Gjykata pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, ka vlerësuar se prapësimi i debitorit të përbarimit, M.B.Th, nga fshati Retijë, Komuna e Rahovecit, i ushtruar kundër urdhrin të përbaruesit privat P.nr.85/2024 të datës 22.01.2024, është i pas afatshëm.

Sipas nenit 69 par. 1 të LPP-së, parashihet se *“prapësimi mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të organit përbarues me të cilin përbarimi është i lejuar”*. Ndërsa, në par. 2 dhe 3 të LPP-së, përcaktohet se *“prapësimi duhet të paraqitet me shkrim në gjykatën themelore”*. Ndërsa, lidhur me afatin për paraqitjen e prapësimit, në nenin 70 të LPP-së shprehimisht parashihet se *“prapësimi duhet t'i paraqitet gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përbarues ose urdhrin përbarues”*.

Në nenin 110.1 të LPK-së përcaktohet se *“Padia, përgjigjja në padi, letërthirrja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankim i veçantë, mjeti i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj. Shkresat e tjera do t'i dorëzohen personalisht adresatit kur një gjë e këtillë shprehimisht parashihet me këtë ligj apo kur gjykata konkludon se për shkak të dokumenteve origjinale që i janë bashkangjitur shkresës që duhet dorëzuar, ose nga ndonjë shkak tjetër, nevojitet kujdes i shtuar”*. Në paragrafin 2 të këtij neni parashihet që *“Në qoftë se personi të cilit duhet dorëzuar personalisht shkresa nuk gjendet atje ku duhet bërë dorëzimi, dorëzuesi do të njoftohet se kur dhe ku do të mund ta gjejë këtë person dhe do t'ia lejë ndonjë personi të theksuar në nenin 111 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji njoftimin me shkrim që për marrjen e shkresës të jetë në ditën dhe në orën e caktuar në banesën e vet, përkatësisht në vendin e vet të punës”*. Ndërsa në paragrafin 3 të këtij neni parashihet që *“Po që se edhe pas kësaj dorëzuesi i shkresës nuk e gjen personin të cilit duhet dorëzuar shkresa, atëherë ai do të veprojë sipas dispozitave të nenit 111 të këtij ligji, dhe kështu dorëzimi do të konsiderohet i kryer”*.

Në nenin 111.1 të LPK-së parashihet që *“Po që se personi të cilit duhet bërë dorëzimi i shkresës nuk gjendet në banesën e vet, dorëzimi bëhet duke iu dhënë shkresa ndonjë anëtar i rritur të familjes së tij, i cili ka për detyrë ta marrë shkresën në dorëzim, e po që se as këta nuk gjenden në banesë, shkresa do t'i jepet fqinjit, po që se pajtohet me një gjë të këtillë. Dorëzimi i kryer në këtë mënyrë konsiderohet i vlefshëm”*. Ndërsa në nenin 112 të LPK-së parashihet që *“Kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtar i rritur i familjes së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuar në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, dorëzuesi do t'ia lejë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi i tillë apo do t'ia bashkëngjis shkresën në derën e banesës apo lokalit të punës. Në fletë dërgesë do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa. Komunikimi i kryer në këtë mënyrë quhet i ligjshëm”*.

Pra, sipas këtyre dispozitave ligjore, rrjedh se prapësimi është i pas afatshëm, sepse pas pranimit të shkresave të lëndës P.nr.85/2024 të datës 22.01.2024, e deri në datën e paraqitjes së

prapësimi nga debitori i përbarimit më datë 07.03.2024, kanë kaluar 1 muaj e 2 ditë dhe rrjedhimisht gjykata në përputhje me nenin 73 par. 3 vendosi që prapësimin e palës debitore ta hedhë si të pa afatshëm, për arsyet se dorëzimi i bërë në bazë të fletëkthesës pas tentimit të parë, në tentimin e dytë, është bërë në mënyrë të rregullt.

Prandaj nga ajo që u theksua më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 3, 5, 13, 21, 22 par. 1 pika 9, 71, 73 dhe nenit 77 të LPP-së lidhur me nenin 9, 10, 11 dhe nenit 12 të Ligjit nr.05/L- 118 të datës 18.04.2018 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr.04/L-139 të datës 20.12.2012 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

PPP.nr.9/2024 më datë 17.10.2024

Bashkëpunëtorja profesionale

Adelina Çmega

Gjyqtari

Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, brenda afatit prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.